
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
DOKTOR PLASTIK SH.P.K.**

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
DOKTOR PLASTIK SH.P.K.**

**KREU I
EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
THEMELIMI/EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1 Sot më datë 18.06.2019, unë i nënshkruari Erlis Shkurti, shtetas shqiptar lindur më 28 Tetor 1983 në Tiranë, me banim në Tiranë, rruga Myslym Shyri, Kulla 3, Kat 3, Apartamenti 3, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 024476182 dhe unë i nënshkruari Arbri Faria, shtetas shqiptar, lindur më 1 Maj 1987 në Fier, me banim në Tiranë, Sheshi Karl Topia, Kulla 3, Kat 3, Apartamenti 5, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 030098104, themelojmë sot një shoqëri me përgjegjë të kufizuar me emrin Doktor Plastik dhe nënshkruajmë këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë së re.
- 1.2 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**Doktor Plastik**" (më poshtë e quajtur "**Shoqëria**").

**NENI 2
SELIA**


- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Njësinë Bashkiake № 7, Rr. Dritan Hoxha, Pallati Green Construksion (pranë pallatit Asllan Rusi), Hyrja 1, Kat 3, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbylli degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar.

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:



- a) Import-eksport të produkteve mjekësore apo farmaceutike, kozmetike, ushqimore, industriale, të kryejë sipërmarrje dhe shërbime në fushën e mjekësisë, kirurgjive të ndryshme, ngritja e qëndrave të ndryshme laboratorike/ekzaminimi, estetike, klinika, spitale, etj; kryerja e transaksioneve në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, kryerja e veprimeve dhe/ose pjesëmarrja në cdo veprim ose aktivitet në perputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë, apo cdo veprimitari në lidhje me to dhe cdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimitarisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin Shqiptar. Të tregtojë të gjitha llojet e pajisjeve, pjesëve të këmbimit si dhe të çdo tjetër mjeti i nevojshëm për ushtrimin e shërbimeve të mësipërme. Të kryej cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barre hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqerisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore të citura me siper. Të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi;
- b) të ofrojë shërbime këshilluese biznesi dhe menaxhimi shoqërive të tjera si kërkime tregu, shërbime profesionale, teknike dhe shkencore si edhe shërbime të tjera këshilluese;
- c) të përvetësojë dhe të shesë pjesëmarrje ose interesa të tjera në korporata, shoqëri tregtare dhe ndërmarrje, të bashkëpunojë me to dhe të drejtojë këto korporata, shoqëri tregtare ose ndërmarrje;
- d) të blejë, të shfrytëzojë për arsyet tregtare dhe të shesë pronësinë mbi të drejtat intelektuale dhe/ose industriale, përfshirë know-how, pavarësisht nëse janë apo jo të patentuara, dhe të përvetësojë, të shfrytëzojë për arsyet tregtare dhe të shesë prona;
- e) të japë dhe të marrë hua parash, në veçanti – por pa u kufizuar në – hua kundrejt korporatave dhe shoqërive tregtare të cilat janë filiale dhe/ose të lidhura me Shoqerinë ose në të cilat Shoqëria ka ndonjë interes, si edhe të térheqë ose të mundësojë térheqjen e huave të parave;
- f) të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj dhe janë në favor të qëllimeve si më sipër ose për secilën prej tyre.
- 4.2 Shoqëria mund të marrë pjese në mënyrë te drejtpërdrejtë ose térthortë në çdo shoqëri që ka të objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e Shoqërisë. Për këtë qëllim, shoqëria mund të bashkëpunojë me, ose në çdo mënyrë tjetër, te drejtpërdrejtë ose térthortë, ta marrë pjese në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose që kanë lidhje me objektin e shoqërisë ose ndihmës për realizimin e objektit të shoqërisë. Shoqëria për të garantuar detyrimet e veta dhe ato të palëve të treta mund të vendosë garanci, si peng ose barrë hipotekore, përfshirë aktivitetin e saj. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryeje çdo aktivitet

ekonomik, finansiar, veprime me pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, pjesërisht ose plotësisht, çdo tregti ose aktivitet tregtar dhe të zhvilloje çdo tregti ose aktivitet tjetër fitimprurëse i cili mund të jetë mund të jetë fitimprurës ne lidhje me aktivitetet tregtare të shoqërisë.

- 4.3 Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj.

Për këtë qëllim, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, funksional, ndihmës, të ngjashëm ose të dobishëm për përbushjen e objektit të saj.

- 4.4 Për përbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ndihmëse ose të lidhura, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve të saja ose të shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontroll të përbashkët.

**KREU II
KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE,
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**NENI 5
KAPITALI I SHOQËRISË**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100'000 Lekë (një qind mijë Lekë), i perbere nga 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet tërësisht nga ortakët sipas kontributieve të mëposhtme:

- Z. Erlis Shkurti, shtetas shqiptar, lindur më 28 Tetor 1983 në Tiranë, me banim në Tiranë, Rr. Myslym Shyri, Kulla 3, Kati 3, Apartamenti 3, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 024476182, zotëron një kuotë pjesëmarrje të barabartë me 50'000 Lekë (pesëdhjetë mijë Lekë), e barazvlefshme me 50% të kapitalit të Shoqërisë;
- Z. Arbri Faria, shtetas shqiptar, lindur më 1 Maj 1987 në Fier, me banim në Tiranë, Sheshi Karl Tpia, Kulla 3, Kati 3, Apartamenti 5, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 030098104, zotëron një kuotë pjesëmarrje të barabartë me 50'000 Lekë (pesëdhjetë mijë Lekë), e barazvlefshme me 50% të kapitalit të Shoqërisë.

- 5.2 Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotat përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Mënyrat e ushtrimit të të drejtës së parablerjes do të përcaktohen në marrëveshjen e firmosur nga ortakët e Shoqërisë.
- 5.3 Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 5.2, secili ortak mund të shesë lirisht, plotësisht ose pjesërisht, kuotën e tij një shoqërie të kontrolluar nga ky ortak.
- 5.4 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë në atë datë.

NENI 6
SHLYERJA E KONTRIBUTIT TË SHOQËRISË DHE ANULLIMI I
KUOTAVE TË PAPAGUARA NGA ORTAKËT

- 6.1 Organi i administrimit mund t'u kërkojë ortakëve shlyerjen e kontributeve të pashlyera nëpërmjet një paralajmërimi me shkrim prej 14 ditësh, duke treguar vlerën, vendin, kohën dhe mënyrën e pagesës. Shlyerja e kuotës së nënshkruar nga ortaku, mund të bëhet edhe me këste nëse parashkohet në lajmërimin e pagesës. Ortaku të cilit i drejtohet lajmërimi me shkrim për shlyerjen sipas këtij nenit, do të jetë përgjegjës për shlyerjen e kuotës së Shoqërisë edhe në rastin kur i ka kaluar pjesëmarrjen e tij një të treti.
- 6.2 Ortakët që zotërojnë të njëjtën kuotë pjesëmarrjeje do të përgjigjen në mënyrë solidale për shlyerjen e kontributeve.
- 6.3 Ortaku që nuk ka shlyer kuotën e tij të pjesëmarrjes brenda afatit të parashikuar në nenin 6.1 të këtij Statuti, do të jetë i detyruar të paguajë një interes vjetor vonese në masën 4%, duke nisur nga data e parashikuar për pagesën.
- 6.4 Në rast se ortaku nuk e ka shlyer kontributin brenda afatit të parashikuar në nenin 6.1 të këtij Statuti, Administratori mund t'i dërgojë ortakut një paralajmërim të dytë me shkrim prej 14 ditësh, duke i kërkuar shlyerjen e kontributeve bashkë me interesat mbi vonesën. Lajmërimi duhet të tregojë vlerën e kontributit për tu shlyer, vendin, kohën dhe mënyrën e pagesës, si dhe deklarimin se kuota e pjesëmarrjes do të anullohet nëse kontributet nuk shlyhen brenda afatit dhe mënyrave të përshkruara.
- 6.5 Nëse ortaku nuk ka shlyer kontributet e kërkua brenda afatit dhe mënyrave të përshkruara në lajmërimin për pagesën, kuota përkatëse e pjesëmarrjes mund të anullohet dhe likuidohet me vendim të Administratorit me efekt mbi dividendët ose pagesave të tjera në lidhje me këtë kuotë, që nuk rezultojnë të paguara në momentin e anullimit.

5

- 6.6 Në përputhje me dispozitat ligjore, kuota e anulluar mund të kalohet, shpërndahet ortakëve ose shitet sipas afateve dhe mënyrave të vendosura nga Administratori.
- 6.7 Titullari i kuotës së anulluar humb cilësinë e ortakut të Shoqërisë në lidhje me kuotën dhe do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për të gjitha shumat që duhet të paguheshin deri në datën e annullimit të kuotës, bashke me interesat e vonesës të llogaritura deri në ditën e annullimit të kuotës.

NENI 7
KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI
OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT TË ORTAKUT

- 7.1 Kuotat janë lirisht të trashëgueshme në rast vdekje të ortakut, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut të vdekur, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.
- 7.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kérkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqerinë në lidhje me këtë zgjedhje.
- 7.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKR si zotërues i kuotës.

NENI 8
ZMADHIMI I KAPITALIT

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, miratuar me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.10 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.
- 8.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të zmadhimit të kapitalit, pjesa e kapitalit të panënskruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërisht të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 9
ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, miratuar me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.10 të këtij Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të përcaktuar me ligj.
- 9.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim me kuotat e tyre.

KREU III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përpjesëtim me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 10.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i tretë i deleguar me prokurë me shkrim.
- 10.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën dhe videokonferencën, në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori ose njëri nga ortakët e Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, nëpërmjet telefaksit ose letrës me detyrim njoftimi, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga respektimi i këtyre formalitetave, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre bien dakord për rendin e ditës.

- 10.6 Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme kryesohen nga Administratori. Asambleja e Përgjithshme mund të caktojë nga personat e pranishëm një sekretar për çdo mbledhje ose një person tjetër edhe pa patur cilësinë e ortakut.
- 10.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 10.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.
- 10.9 Asambleja e Përgjithshme, përveçse sa përcaktohet në nenin 10.10 të këtij Statuti, vndos me shumicën e ortakëve pjesëmarrës me të drejtë vote, që përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë.
- 10.10 Asambleja e Përgjithshme vndos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës, nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë, për ndryshimet e Statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë.

NENI 11 FINANCIMI

- 11.1 Administratori, me qëllim përbushjen e objektit të Shoqërisë, mund ti kërkojë financime të tretëve dhe financime të tjera ortakëve, të ndryshme nga zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë.
- 11.2 Financimet e ortakëve do të jepen kundrejt shpërblimit (pagesës së interesave) ose falas, në bazë të titullit për të cilin jepet financimi.
- 11.3 Çdo operacion financimi, si dhe çdo marrje përsipër e detyrimeve financiare, duhet të jetë diskutuar dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 12 ADMINISTRATORI

- 12.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i zgjedhur për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori zgjidhet, rizgjidhet ose shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë. Administratori i parë do të caktohet personi i mëposhtëm:
- Z. Erlis Shkurti, shtetas shqiptar, lindur më 28 Tetor 1983 në Tiranë, me banim në Tiranë, Rr. Myslym Shyri, Kulla 3, Kat 3, Apartamenti 3,

mbajtës i kartës së identitetit me nr. 024476182.

- 12.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përvèç atyre që i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.
- 12.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interes, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 13
PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORËVE

- 13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- (b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- (c) personi vuani ose mund të vuajë nga çrrregullime mendore;
- (d) personi jep dorëheqjen, ose
- (e) ka munguar pa arsyё në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe është shkarkuar nga detyra nga Asambleja e Përgjithshme.

KREU V
KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË,
VITI FINANCIAR, BILANI CJETOR, DIVIDENDI

NENI 14
KONTROLLI FINANCIAR

- 14.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 15
VITI FINANCIAR

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 16
BILANCI VJETOR**

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme reportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe dokumentat financiare vjetore.
- 16.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin finanziar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

**NENI 17
DIVIDENDI**

- 17.1 Në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë votash të Asamblesë të Përgjithshme sipas kuorumit të parashikuar në nenin 10.10, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përpjestim me të drejtat përkatëse të ortakëve.

**KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

**NENI 18
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 18.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.


**NENI 19
LIGJI I ZBATUESHËM**

- 19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe legjislacionin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NENI 20
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 20.1 Mosmarrëveshet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjera dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 21



10

GJUHA

21.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT


Erlis Shkurti


Arbri Faria

